



PRANUAR NË:

A DEP ED UR 01/10/2024

PRIMARJENI:

Nr. Mb. Pr. 02/409



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës në Malishevë
Komisioni Vlerësues

Nr./_____

Datë; 01.10.2024

Komisioni Vlerësues, i formuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/111, dt.07.03.2024, duke vepruar sipas dispozitave Ligjore të Ligjit nr.06/L092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 19, Rregullore së Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 21 par 21.3, Thirrjes Publike për shprehjen e Interesit sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, numër 02/121, datë, 08.03.2024, dhe me datë 01.10.2024 bënë këtë,

NJOFTIM PUBLIK

Komisioni duke vepruar në harmoni me Rregulloren e lartcekur, dhe evidentimin e dokumentacionit, ka konstatuar se kemi pasur vetëm një ofertë, sipas thirrjes publike, që mbanë numrin, 02/357, dt.20.08.2024.

Kompania ofertuese: “ B Famis “ Sh.p.k, me seli në Suharekë.

Përshkrimi i ofertës: *Hapësira e ndërtimit B+P=8, gjithsejtë, 15,880 m² me hapësirat e përbashkëta, ndërsa pa hapësirat komunikuese B+P+8 =13,200 m².*

Vlera e investimit në kompleksin Afaristo Banesor : 5,000.000.00 €.

Oferta e operatorit për Komunën e Malishevës.

1). Oferta e parë :Çmimi i ofertës për Komunën e Malishevës: 32 %, të tërësisë së objektit të ndërtuar.

Afati i realizimit: *Ky objekt sipas ofertës është parashikuar të realizohet për 30 muaj.*

2). **Oferta e dytë** : “ Ndërtim i rrugës me trotualet nga ura e qytetit deri tek ura e tranzitit me gjatësi 650-750 m, së bashku me rrënimin e objekti të, *Kullës dhe të Muzeut të Qytetit*, në vlerë prej 1,600.000.00 €.

3). **Oferta e tretë**: Ndërtim i kanalizimit sipas nevojës së Komunës së Malishevës L=2,000 m¹ gypa PESN 8 (fi 500-800 mm) varësisht nga kërkesa e investitorit, në vlerë prej 1,600.000.00 €.


Bazuar në nenin 21 paragrafi 4, të Rregullores QRK (09/2020) për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, shpallë ofertën e vetme njëherit vendosi që e njëjta të publikohet në **tabelën e shpalljeve** dhe **Web faqen** zyrtare të komunës së Malishevës.

Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese, në Komisionin e Ankesave, i formuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 18 të Rregullores, dhe atë brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Pas përfundimit të afatit për ankesë, ky komision do të përgatis raport me shkrim për punën e tij për Kuvendin e Komunës së Malishevës, të cilit do t'i bashkëngjitet edhe kjo ofertë sipas thirrjes publike, pastaj mbetet në autoritetin dhe kompetencën e Kuvendit të Komunës për procedurë të mëtejme në lidhje me këtë qështje.

Komisioni vlerësues:

1. Muharrem Morina- Kryetari i Komisionit,
2. Halil Morina-anëtar,
3. Fitim Shala- anëtar,
4. Eqrem Morina- anëtar,
5. Ardian Mazreku-anëtar,



Vendi dhe data: Malishevë, 01.10.2024

